

VENDIM
Nr.921, datë 15.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NDËRMJET NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE
NË INVESTIME DHE BRENDË PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E
BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore në investime, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, t’i shtohet fondi 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë, për projektin “Sistemi i monitorimit me kamera të qytetit të Tiranës”;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor “Mbështetja e Luftimit”, t’i pakësohet fondi 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë, për projektin “Rikonstruksion i QKU-së, ESKU-së, Tiranë”.

2. Rishpërndarja e fondeve brenda programeve buxhetore të Ministrisë së Brendshme të bëhet sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1 (Rialokimi ndërmjet programeve)

Shtesë

në lekë

Ministria e Linjës	Emër Institucioni	Prog.	Llog.Ekonom.	Debiti	Emërtimi
16	Policia e Shtetit	03140			
	Shpenzime të tjera		602	120 000 000	Spoti publicitar lidhur me liberalizimin e vizave
	Rezervat Materiale të Shtetit	01180			
	Shpenzime të tjera		602	17 836 000	Vendim gjyqësor
	Totali			137 836 000	

Pakësim

Ministria e Linjës	Emër Institucioni	Prog.	Llog.Ekonom.	Debiti
16	Garda e Republikës	03150		
	Shpenzime për paga		600	110 000 000
	Shpenzime për sigurime shoqërore		601	5 000 000
	Shpenzime të tjera		606	5 000 000
	Policia e Shtetit	03140		
	Shpenzime për sigurime shoqërore		601	17 836 000
	Totali			137 836 000